

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9942, DATË 26.6.2008, “PËR PARANDALIMIN E ÇRREGULLIMEVE TË SHKAKTUARA NGA PAMJAFTUESHMËRIA E JODIT NË ORGANIZMIN E NJERIUT”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllimin për të parandaluar çrregullimet e shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut.

Ndryshimet e propozuara kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës, analizat laboratorike për përcaktimin e nivelit të jodit në mostrën e kripës së jodizuar, në mënyrë që të ato të bëhen sipas rekomandimeve të OBSH-së, ICCIDD-it dhe UNICEF-it, si dhe përcaktimin e institucioneve që do të kryejnë monitorimin dhe inspektimin e kontrollit të kripës së jodizuar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me zbatimin e objektivave të parashikuara në programin e qeverisë.

Projektakti është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim, gjatë vitit 2019, pranë Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Hartimi i këtij projektligji synon përmirësimin e ligjit dhe forcimin e zbatimit të tij për rritjen dhe përmirësimin e standardeve për konsumimin e kripës së jodizuar në popullatën shqiptare.

Gjatë viteve të fundit ka pasur një rritje të ndjeshme të prodhimit në vend të kripës së pajodizuar dhe të fortifikimit të saj me jod, si dhe të numrit të stabilimenteve që operojnë në këtë fushë. Përveç prodhimit të kripës në vend, është vënë re një rritje e ndjeshme e importit të kripës së pajodizuar dhe fortifikimit të saj në vend nga këto stabilimente.

Për këtë qëllim, me urdhrin nr.469, datë 3.11.2017, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u ngrit grupi i punës për hartimin e ndryshimeve ligjore të ligjit nr.9942, datë 26.6.2008, “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, të ndryshuar.

Ky grup pune kreu një analizë të situatës aktuale, nëpërmjet vlerësimit të zbatimit të tij në të gjitha nivelet, pikat e prodhimi të kripës së jodizuar, pikat e përpunimi të industrisë ushqimore, procesin e monitorimit të kripës së jodizuar nga strukturat përkatëse nëpër rrethe, të përcaktuara me ligj, procesin e inspektimit nga ISHSH-ja, nëpërmjet organizimit të vizitave vlerësuese nëpër rrethe, me pjesëmarrje të ekipeve të përbashkëta të Ministrisë së Shëndetësisë, ISHP-së dhe ISHSH-së.

Gjatë këtij procesi vlerësimi doli e qartë nevoja për përcaktim dhe ndarje të qartë të kompetencave ndërmjet strukturave lokale të ISHSH-së dhe drejtorive të shëndetit mjedisor pranë DRSH-ve, sa i takon procesit të monitorimit të jodit në kripë, dhe një nevojë për një bashkëpunim me të mirë mes këtyre strukturave.

Në këtë proces të vlerësimit të nevojave për ndryshime në ligj, u propozua ringritja dhe funksionimi i Komitetit Kombëtar për Eliminimin e Çrregullimeve nga Pamjaftueshmëria Jodike (KKEÇPJ), i cili rifilloi funksionimin e tij me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji hartohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji ka gjithsej 9 nene. Në nenin e parë termi “ministri/a e/i shëndetësisë” zëvendësohen me “ministri/a përgjegjës/e për shëndetësinë”.

Neni 2 i projektligjit parashikon ndryshim të termave “Konsum direkt” dhe “Konsum indirekt”, të cilët zëvendësohen, përkatësisht me “Konsum i drejtpërdrejtë” dhe “Konsum i tërthortë”.

Neni 3 i projektligjit shton në nenin 6 paragrafët me këtë përmbajtje:

“Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar vetëm me qëllim fortifikimin e kripës me jod nga subjekte të licencuar për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin.

Lejohet përdorimi i kripës së pajodizuar në prodhimin e ushqimeve, përgatitja e të cilave parashikon domozdoshmërisht përdorimin e kripës së pajodizuar. Këto ushqime përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për ushqimin.

Lejohet eksporti i kripës së pajodizuar dhe i ushqimeve të prodhuar me kripë të pajodizuar në vende ku nuk ekziston ndalimi i përdorimit të kripës së pajodizuar.”.

Në nenin 4 të projektligjit bëhet riformilimi i nenit 12 të ligjit, si më poshtë vijon:

“Neni 12
Kontrolli i kripës së jodizuar

1. Kripa e jodizuar, e prodhuar ose e importuar, e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë, është objekt kontrolli.
2. Kontrolli i kripës së jodizuar përfshin veprimtaritë e mëposhtme:
 - a) Monitorimin, i cili kryhet nga drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë;
 - b) Inspektimin, i cili kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë.
3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë përcakton institucionet shëndetësore që do të kryejnë analizat, për përcaktimin e nivelit të jodit në kripën e jodizuar.
4. Kontrolli i kripës së jodizuar bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, nëpërmjet analizave laboratorike për përcaktimin e nivelit të jodit në mostrën e kripës së jodizuar, sipas rekomandimeve të OBSH-së, ICCIDD-it dhe UNICEF-it.”.

Në nenin 5 shtohet neni 12/1, si më poshtë vijon:

“Neni 12/1
Kontrolli i kripës së jodizuar në pikat doganore

1. Kripa e jodizuar, që importohet në Republikën e Shqipërisë nga subjektet importuese, i nënshtrohet kontrollit në pikat doganore (degët doganore kufitare). Ky kontroll realizohet nga autoriteti doganor, drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë dhe inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë.

2. Për kripën e jodizuar të importit, edhe në rastet kur në dokumentet shoqëruese është pasqyruar niveli i jodit, importuesi është i detyruar të kryejë analizën laboratorike për nivelin e jodit, në çastin e futjes së kripës në pikën doganore.
3. Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe për kryerjen e analizave laboratorike të nevojshme për kontrollin e kripës së jodizuar përballohen nga operatori i biznesit ushqimor përgjegjës për ngarkesën. Tarifat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6 i projektligjit parashikon riformulimin e nenit 13, si më poshtë vijon:

“Neni 13
Monitorimi i kripës së jodizuar

1. Monitorimi i nivelit të jodit në kripë, në pikat e prodhimit në vend apo në ato të importimit dhe në pikat e shitjes me pakicë/shumicë, kryhet nga drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë brenda juridiksionit të tyre, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e këtij institucioni.
2. Prodhuesi i kripës së jodizuar në vend dhe importuesi i saj janë përgjegjës për cilësinë e kripës së jodizuar.”.

Neni 7 parashikon shtesën e një neni të ri, që lidhet me kërkesat për gjurmueshmërinë e kripës për konsum human shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore me këtë përmbajtje:

“Neni 13/2
Kërkesat për gjurmueshmërinë e kripës për konsum human shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore

1. Operatori i biznesit ushqimor krijon dhe mban informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, jodizimit të kripës dhe shpërndarjes së saj.
2. Informacioni i nevojshëm për gjurmueshmërinë përfshin këto të dhëna:
 - a) Identitetin e çdo subjekti tregtar/personi juridik apo fizik, nga i cili operatori i biznesit ushqimor është furnizuar me kripë;
 - b) Identitetin e çdo subjekti tregtar, të cilin operatori i biznesit ushqimor e ka furnizuar me kripë.
3. Operatori i biznesit ushqimor ruan të dhënat e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, për jo më pak se 3 vjet dhe siguron që këto të dhëna t’i jepen menjëherë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe inspektoratit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Kripa ushqimore e nxjerrë në treg ose që mund të nxirret në treg duhet të etiketohet dhe të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë.”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ISHP-ja dhe ISHSH-ja.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me grupin e punës, i cili kreu një analizë të situatës aktuale nëpërmjet një vlerësimi të zbatimit të tij në të gjitha nivelet, pikat e prodhimit të kripës së jodizuar, pikat e përpunimit të industrisë ushqimore, procesin e monitorimit të kripës së jodizuar nga strukturat përkatëse nëpër rrethe, procesin e inspektimit nga ISHSH-ja, nëpërmjet organizimit të vizitave vlerësuese nëpër rrethe, me pjesëmarrje të ekipeve të përbashkëta të MSHMS-së, ISHP-së dhe ISHSH-së.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare.

KËSHILLI I MINISTRAVE